**VENDIM**
**Nr.695, datë 31.3.2008**

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR "TV LEZHA"**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit fizik z.Fred Stakaj për televizionin privat kabllor "TV Lezha", me nr.licence 023/RTVK, për në komunat Shëngjin dhe Balldren.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Licencave, Drejtoria Teknike dhe Drejtoria Ekonomike për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
**Mesila Doda (Demi)**